

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 21 KORRIK 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë, që na ndiqni në këtë orë të vonë të natës,

Edhe unë, njëlloj si kolegët e tjerë parafolës, jam e bindur se sot ligji “Për krijimin e regjistrit kombëtar të të dënuarve për krime seksuale” do të ketë marrë dakordësi të plotë, dakordësi unanime nga të gjithë deputetët e këtij parlamenti. Unë mendoj se nuk mund të ketë asnjë qytetar, brenda apo jashtë kësaj salle, që ka mëdyshje apo ka rezerva ndaj qëndrimit që ne si shoqëri duhet të mbajmë ndaj krimeve të tilla. Legjislacioni duhet të jetë i pari që të garantojë mbrojtje për qytetarët dhe parandalimi më i mirë realizohet nëpërmjet një mjeti të fortë, nëpërmjet një mjeti të sigurt, që mund të jetë vetëm mjeti ligjor.

Arsyeja për të cilën e kërkova fjalën, lidhet me angazhimin maksimal të të gjitha institucioneve tona arsimore, jo vetëm për ta zbatuar këtë ligj me korrektesë, por për ta reflektuar atë në të gjitha aktet tona ligjore, nënligjore, rregullatore, udhëzimet e gjithçka tjetër. Në fakt, qëndrimin tonë si institucione arsimore e kemi shprehur edhe më herët. Që në dhjetor të vitit të kaluar, duke u nisur edhe nga një rast konkret që shkaktoi zemërim në opinionin publik, unë kam firmosur menjëherë një udhëzim që i ndalon për të aplikuar dhe për të konkurruar si mësues të gjithë individët e dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e çdolloj vepre penale ndaj të miturve, por edhe ndaj institucioneve arsimore.

Menjëherë pas udhëzimit ne u angazhuam që të ndërmarim edhe iniciativa të tjera ligjore për të garantuar edhe më shumë mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve tanë. Për këtë arsye, menjëherë sapo filluam punën për rishikimin e ligjit të arsimit parauniversitar, para disa muajsh, ligj, i cili aktualisht është në konsultim publik me të gjithë aktorët e sistemit, ne kemi shtuar një nen në ligj që përcakton qartë se këta persona nuk mund të ushtrojnë as profesionin

e mësuesit, por as edhe një pozicion tjetër në institucionet tona arsimore, pavarësisht rehabilitimit të tyre.

Pra, ne nëpërmjet ligjit të ndryshuar të arsimit parauniversitar nuk do të lejojmë as mësues, as punonjës të shërbimit psikosocial, as mësues ndihmës, as drejtorë dhe as njëloj pozicioni tjetër brenda mureve të institucioneve tona arsimore. Këtu nuk kemi parashikuar vetëm krimet seksuale, por çdo lloj veprë penale ndaj të miturve që mund të jetë edhe dhuna apo çdo lloj tjetër abuzimi. E përsëris, jo vetëm vepra penale ndaj të miturve, por edhe vepra penale ndaj institucioneve arsimore, që mund të jenë vjedhje, abuzime me numrat e amzës apo shitje diplomash. Pra, e kemi zgjeruar edhe më shumë rrethin e veprave penale, që ne nuk i pranojmë brenda institucioneve tona arsimore.

Por që kjo pikë e ligjit të arsimit parauniversitar të zbatohet siç duhet, ne kishim nevojë për një ligj si ky që po miratohet sot, që garanton monitorimin, garanton raportimin e të dhënave personale të këtyre individëve të shënuara në regjistrin kombëtar. Me anë të këtij ligji, natyrisht, edhe të ligjit të arsimit parauniversitar, ne angazhohemi për të marrë të gjitha masat që të mos lejojmë që nxënësit tanë të jenë të rrezikuar përpara individëve që kanë kryer vepra penale si këto. Ne nuk do të lejojmë rrezikun e ripërsëritjes së veprës penale. Ne do të punojmë dhe do të angazhohemi fort që mjediset arsimore të jenë mjedise të sigurta dhe mjedise të shëndetshme. Ne do të punojmë akoma më shumë që figura e mësuesit të përcjellë virtyte, të përcjellë siguri, vlera, të përcjellë integritet moral dhe ligjor.

Ne këtë nuk do ta bëjmë vetëm me anë të ligjit, por, natyrisht, ne kemi edhe shumë mjete të tjera, si: shërbimin psikosocial në shkollë, oficerët e sigurisë, projekte, aktivitete ekstrakurrikulare për t'i informuar nxënësit për rreziqet që mund t'u kanosen atyre brenda dhe jashtë mureve të shkollës. Kështu, edhe një herë, ashtu si edhe kolegët e tjerë, unë shpreh shumë falënderime për nismëtarët, për kolegen Erisa Xhixho, por, gjithashtu, edhe për 20 mijë zgjedhësit që kanë dhënë kontributin e tyre, ashtu sikurse të gjithë kolegët deputetë të komisioneve që kanë punuar intensivisht. Shumë faleminderit të gjithëve për punën dhe le të punojmë të gjithë së bashku për ta zbatuar siç duhet këtë ligj! Faleminderit!